



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-078

Prishtinë, më 8 tetor 2012, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 8 TETOR 2012

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, Sabri Hamiti dhe Glauk Konjufca, Petar Miletqi dhe Enis Kervan, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Ardian Gjini, Myzejene Selmani, Sasha Milosavleviq dhe Myfera Shinik.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi, Bilall Sherifi dhe Skënder Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca;

Nga OSBE-ja: Floriana Shala.

Mbledhjen e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia i zhvilloi punimet me këtë:

R e n d i t e

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 1 tetor 2012,
2. Procedimi i mocionit dhe i rezolutës lidhur me procesin e privatizimit në Kosovë,
3. Caktimi i datës për vazhdimin e mbledhjes plenare, e ndërprerë më 4 tetor 2012,
4. Përgatitjet për seancën plenare të radhës,
5. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave.

* * *

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 1 tetor 2012

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 1 tetor 2012.

Nënkryetari i Kuvendit, Sabri Hamiti, pati vërejtje në transkript, përkatësisht në faqen 11, në të cilën është evidentuar gabimisht një pjesë e diskutimit të tij. Togfjalëshi “do ta ndërroj” është dashur të jetë “do ta votoj”. Transkripti është korrigjuar sipas kësaj vërejtjeje.

2. Procedimi i mocionit dhe i rezolutës lidhur me procesin e privatizimit në Kosovë

Kryesia, pasi diskutoi për vazhdimin e mbledhjes plenare, të ndërprerë më 4 tetor 2012, vendosi që Kuvendit t’i propozojë ta vazhdojë mbledhjen më 11 tetor 2012, me këtë:

R e n d i t e

1. Procedimi i mocionit për procesin e privatizimit në Kosovë, i propozuar nga grupet Parlamentare - LDK, VV dhe AAK dhe i rezolutës për procesin e privatizimit në Kosovë, i propozuar nga GP i PDK-së.

3. Caktimi i datës për vazhdimin e mbledhjes plenare, e ndërprerë më 4 tetor 2012

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me caktimin e datës për vazhdimin e mbledhjes plenare, të ndërprerë më 4 tetor 2012, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që mbledhja plenare të mbahet me 11 tetor 2012, me këtë:

Rend dite

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
4. Votimi i Raportit vjetor të performancës me pasqyrat e audituara financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2011,
5. Interpelanca me ministrin Enver Hoxhaj, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të LDK-së, lidhur me gjendjen në politikën e jashtme të Kosovës,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për pagat e funksionarëve publikë,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për provimin e jurisprudencës,
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti,
10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për komunikimet elektronike,
11. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Universitetit të Prishtinës, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2011,
12. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve në Bordin e Pavarur për Rishqyrtimin e ankesave,
13. Shqyrtimi i Statutit të Universitetit të Prishtinës dhe
14. Debat parlamentar, sipas kërkesës së deputetes Alma Lama, lidhur me shpenzimin e fondeve publike nga Qeveria e Kosovës.

4. Përgatitjet për seancën plenare të radhës

Kryesia diskutoi për përgatitjet e nevojshme për mbajtjen e mbledhjes plenare të radhës, por caktimin e datës dhe rendin e ditës e shtyu për mbledhjen e ardhshme të Kryesisë.

5. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave:

1 Kërkesa e Komisionit të Pavarur për Media

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e lartshënuar, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Buxhet dhe Financa, si komision funksional, që ta shqyrtojë kërkesën e Komisionit të Pavarur për Media lidhur me kompensimin e anëtarëve të KPM-së dhe Kryesisë së Kuvendit t'ia paraqesë rekomandimin lidhur me këtë çështje.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 10:25 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi: Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale